



DEKLARATË

Moskonsensusi politik i anëtarëve të

Komisionit Parlamentar të Ligjeve në përzgjedhjen e dy prej katër kandidaturave, detyrim për rishpalljen sërish të vendit vakant të Kryetarit të KQZ-së

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka nisur procesin e përzgjedhjes dhe plotësimit të vakancës për Kryetar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Pas shpalljes së thirrjes për kandidatët e interesuar, dëgjësave me individët që kishin paraqitur kandidaturat, procesi është në një moment delikat. Nga 6 kandidaturat fillestare, tërheqjes së njërave prej tyre, dhe ku një tjetër është qartësisht një figurë me angazhim politik¹, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut është **realisht vetëm përballë katër kandidaturave.**

Kodi Zgjedhor në Nenin 15 parashikon përzgjedhjen e dy kandidaturave prej Komisionit Parlamentar të ligjeve me jo më pak se 2/3 e votave të anëtarëve të tij. Dy kandidaturat kalojnë për votim në seancë plenare në Kuvend, ku kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të deputetëve, zgjidhet Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në rast se Komisioni i Ligjeve nuk arrin t'i përzgjedhë të dy kandidaturat me jo më pak se 2/3 e votave të anëtarësisë së tij, atëherë nga katër kandidaturat që kanë marrë më shumë vota, përfaqësuesit e pakicës në Komision përjashtojnë dy nga katër kandidaturat. Dy kandidaturat që mbeten i kalojnë seancës parlamentare për votim.

Duke qenë se vetëm katër kandidatura janë alternativat e Komisionit Parlamentar, në rast të mos arritjes së dakortësisë mbipartizane për dy kandidatura, mekanizmi zhblokues i parashikuar do të mbartë pikëpyetje procedurale dhe me e rëndësishmja mund të shërbejë në delegjtimin e kandidaturës fituese në të ardhmen.

Kodi Zgjedhor përcakton se në rast të mospërzgjedhjes së dy kandidaturave me mbështetje mbipartizane, *“komisioni identifikon katër kandidatët që kanë marrë mbështetjen më të madhe midis anëtarëve të komisionit”*. Në një rast të tillë **kuptohet se më së paku numri i kandidaturave në garim do të duhej të jetë më i madh se katër.**

Nga ana tjetër, **edhe pa marrë në konsideratë interpretimin procedural** në përzgjedhjen e kandidatëve, interesi më i lartë është jo vetëm zbatimi formal i teksit ligjor, por **besimi i palëve në integritetin e procesit dhe të kandidaturës që do të përzgjidhet.**

Sillet në vëmendje se Kryetari i KQZ-së, është jo vetëm vota përcaktuese në vendimmarrjen e institucionit, por edhe titullari i administratës së tij. Ndaj momenti i përzgjedhjes së tij duhet të jetë pa asnjë të metë në procedurë, në frymë, madje mundësisht të gëzojë besimin dhe mbështetjen konsensuale të të gjitha partive politike parlamentare.

Në këto rrethana, në rast se anëtarësia e Komisionit **nuk do të arrijë përzgjedhjen e dy kandidaturave mbipartizane, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë bën thirrje për rihapjen e procesit të aplikimit për vakancën.**



Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë

Contact: *Tel/fax:* + 355 4 2245078; *Mob.* + 355(0)692469393; (0)682039297;
E-mail: info@zgjedhje.al; *Website:* www.zgjedhje.al;

Ky veprim *së pari* do të shërbente për arritjen e një dakortësie sa më të plotë në përzgjedhjen e kandidaturës fituese dhe manifestimin e vullnetit politik **për gjetjen e një figure përtej valencave politike për drejtimin e një institucioni të pavarur.**

Së dyti, ky veprim do të ishte shfaqje vullneti për një proces meritokracie ndaj kandidatëve të tjerë të interesuar dhe që nuk u bënë pjesë në thirrjen e parë. Atyre figurave që janë në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe që nuk kanë patur besimin se vakanca në fjalë është një vendimmarrje jashtë mbivendosjeve të interesave politikë. Qasje kjo është ushqyer në vazhdimësi nga tradita e sjelljes së institucionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe e diskursit politik.

Në përfundim, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë, edhe në vazhden e Letrës së Hapurⁱⁱ së datës 14 shtator 2016, kujton rëndësinë e momentit të përzgjedhjes së Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rezervat që mund të mbartë ky moment në delegjitimin e proceseve zgjedhore në vazhdim.

Ky shqetësim **sillet në vëmendje jo vetëm në vazhden e problematikave të drejtimit të proceseve zgjedhore dhe të sjelljes e vendimmarrjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por edhe në kontekstin politik ku ndodhemi**, i cili është tejet i ngarkuar me kundërshti dhe mosbesim reciprok.

Tiranë, më 17 Tetor 2016!

ⁱ Referuar kritereve të parashikuara në nenin 12 të Kodit Zgjedhor, vërtetimi i plotësimi apo jo të kriterit të pikës “d) të mos ketë qenë anëtar i ndonjë partie politike në 5 vitet e fundit” është një proces i pamundur dhe spekulativ nga ana e partisë ku aderon, për sa kohë partitë politike nuk janë ligjërish të detyruara për të bërë transparencën dhe publikimin e anëtarësisë së tyre.

Në frymën e ligjit, dispozita përpiqet të sigurojë që kandidati jo thjesht të mos ketë një kartë anëtarësie të partisë politike, por të mos ketë patur angazhim politik të tij e qendrim partizan në linjë dhe dobi të asaj force politike.

Për kandidatin z. Koli Bele ky angazhim politik është i njohur dhe i qartë. Madje sipas CV-së së tij si Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë të paraqitur në faqen e internetit të kësaj ministrie paraqitet se “...nga viti 2011 ka qenë Nën/Sekretar Zgjedhor, si dhe ka përfaqësuar ligjërish Partinë Socialiste në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, etj.” (<http://www.energja.gov.al/al/ministria/ministri/bele-koli>).

ⁱⁱ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë, Letër e Hapur “Përzgjedhja e Kryetarit të ri të KQZ-së, domosdoshmëri për një proces transparent”, datë 14 Shtator 2016. <http://www.zgjedhje.al/index.php?idart=120&gj=sh>.